

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

*Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
dhe Raporti i Audituesit të Pavarur*

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-ii
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDIN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-32

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ("Agjencia") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesit merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, më 31 dhjetor 2013 si dhe performancën e saj financiare dhe fluksin e parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

28 shkurt 2014
Tiranë, Shqipëri



Elvis Ziu
Partner Angazhimi

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	8	330,407,938	152,453,245
Prime sigurimi të arkëtueshme	9	684,388,183	586,858,438
Investime të mbajtura deri në maturim	10	19,391,942,529	15,959,602,922
Prona dhe pajisje, neto	11	67,802,005	56,590,297
Aktive jo materiale, neto	12	3,391,745	811,500
Aktive të tjera, neto	13	3,195,439	2,163,929
TOTALI I AKTIVEVE		20,481,127,839	16,758,480,331
DEYRIMET			
Detyrime të tjera	14	4,047,511	1,759,690
TOTALI I DETYRIMEVE		4,047,511	1,759,690
FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE			
Fondi themeltar	15	400,000,000	400,000,000
Fondi i akumuluar		16,356,720,641	12,971,740,478
Të ardhurat përmbledhëse për vitin		3,720,359,687	3,384,980,163
TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		20,477,080,328	16,756,720,641
TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		20,481,127,839	16,758,480,331

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 8 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga primet e sigurimit	16	2,775,118,878	2,547,690,715
Të ardhura nga interesat	17	1,029,437,022	901,488,542
Të ardhura të tjera operative		433,233	64,000
		3,804,989,133	3,449,243,257
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(15,602,113)	(7,167,402)
Shpenzime të tjera financiare		(1,738,600)	(1,726,797)
		(17,340,713)	(8,894,199)
Shpenzime operative:			
Shpenzime personeli	18	(42,203,811)	(35,499,385)
Shpenzime administrative	19	(20,918,749)	(17,118,521)
Shpenzime amortizimi	11,12	(4,166,173)	(2,750,989)
		(67,288,733)	(55,368,895)
FITIMI NETO PËR VITIN		3,720,359,687	3,384,980,163
Të ardhurat e tjera përmbledhëse		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE		3,720,359,687	3,384,980,163

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 8 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
FITIMI NETO I VITIT	3,720,359,687	3,384,980,163
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	4,166,173	2,750,989
Interes të përlllogaritur për investimet në letra me vlerë	(90,388,969)	162,101,663
Ndryshimet në:		
Prime sigurimi të arkëtueshme	(97,529,745)	(125,801,202)
Aktive të tjera	(1,031,510)	(151,320)
Detyrime të tjera	2,287,821	339,127
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ	3,537,863,457	3,424,219,420
AKTIVITETI INVESTUES		
Blerje e pajisjeve	(14,556,726)	(198,964)
Blerje e aktiveve jo materiale	(3,401,400)	-
Blerje e letrave me vlerë	(3,341,950,638)	(3,376,457,723)
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues	(3,359,908,764)	(3,376,656,687)
Rritja neto e mjeteve monetare gjatë vitit	177,954,693	47,562,733
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	8	104,890,512
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	8	152,453,245

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 8 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Pasqyra e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)


	Fondi themeltar	Fondi i akumuluar	Totali
Më 1 janar 2012	400,000,000	12,971,740,478	13,371,740,478
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	3,384,980,163	3,384,980,163
Më 31 dhjetor 2012	400,000,000	16,356,720,641	16,756,720,641
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	3,720,359,687	3,720,359,687
Më 31 dhjetor 2013	400,000,000	20,077,080,328	20,477,080,328

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 8 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë me vendim Nr. 5 më 21 shkurt 2014 dhe nënshkruar në emër të tij nga:



Toni Gogu
Drejtor i Përgjithshëm



Azmi Stringa
Përgjegjës për Financën dhe Investimet

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI ENTITETIN RAPORTUES

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (“Agjencia” ose “ASD”) është një institucion i pavarur i themeluar në vitin 2002 në bazë të ligjit nr. 8873 datë 29 mars 2002 “Për sigurimin e depozitave” (“Ligji për sigurimin e depozitave”) i ndryshuar me ligjin nr.10106, datë 30 mars 2009 dhe ligji nr.78/2012 datë 26 korrik 2012. Në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia i raporton Bankës së Shqipërisë (“Autoriteti Mbikëqyrës”), Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. ASD-ja është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave dhe e Forumit Europian të Siguruesve të Depozitave.

Agjencia është themeluar me qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozitave të individëve në bankat vendase, degët dhe filialet e bankave të huaja dhe shoqatat e kursim-kreditit që operojnë në Shqipëri. Institucionet, të cilat janë anëtare të skemës së sigurimit, nuk mund të pranojnë depozita të individëve nëse nuk janë të siguruar nga ASD-ja. Kompensimi i depozitave të siguruar fillon kur Agjencia njoftohet me shkrim nga Banka e Shqipërisë mbi ndërhyrjen në një institucion të siguruar ose kur ky institucion likuidohet vullnetarisht.

Bazuar në ligjin për sigurimin e depozitave, veprimtaria kryesore e ASD-së përfshin përcaktimin dhe mbledhjen e kontributeve fillestare nga institucionet që bëhen pjesë e skemës së sigurimit, përcaktimin dhe mbledhjen e primeve vjetore të sigurimit nga institucionet që janë anëtarë të skemës së sigurimit dhe investimin i fondeve të grumbulluara.

Agjencia, bazuar në ndryshimin e ligjit mbi sigurimin e depozitave në 29 mars 2009, siguron deri në 2,500,000 Lek depozitat e individëve në çdo institucion i cili është anëtar i skemës së sigurimit.

Në 31 dhjetor 2013 dhe 2012, të gjitha bankat që operonin në Shqipëri (2013:16, 2012:16) ishin pjesë e skemës së sigurimit. Në 31 dhjetor 2013 dhe 2012, numri i shoqatave të kursim-kreditit të cilat ishin anëtare të skemës së sigurimit të ASD-së ishte zero.

Agjencia e nisi veprimtarinë e saj më 12 tetor 2002. Aktualisht adresa dhe zyrat qendrore të Agjencisë janë në Tiranë (“Rruga e Elbasanit”, Tirana, Shqipëri).

Më 31 dhjetor 2013 Agjencia kishte 23 punonjës (31dhjetor 2012:14).

2. KUADRI RREGULLATOR I VEPRIMTARISË SË ASD-së

Veprimtaria e ASD-së rregullohet nga ligji për sigurimin e depozitave dhe aktet nënligjore përkatëse të nxjerra nga Agjencia dhe Autoriteti Mbikëqyrës. Ligji dhe aktet nënligjore kërkojnë që të ardhurat e mbledhura nga institucionet anëtare të skemës së sigurimit duhet të investohen në tituj të emetuar nga Qeveria e Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë, tituj të emetuar nga qeveri ose banka qendrore të huaja të vlerësuara si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit, tituj të emetuar nga institucione financiare ndërkombëtare të vlerësuara si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit ose të vendosen në depozita afatshkurta në Bankën e Shqipërisë. Të gjitha investimet duhet të kenë një afat maturimi jo më të gjatë se dymbëdhjetë muaj nga data e blerjes së tyre nga Agjencia.

Organi me i lartë drejtues i Agjencisë është Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

3. BAZAT E PËRGATITJES DHE ZBATIMIT TË SNRF

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. BAZAT E PËRGATITJES DHE ZBATIMIT TË SNRF (VAZHDIM)

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqiptar (“Lek”), e cila është monedha funksionale e Agjencisë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme të ndikuara.

Informacione rreth pjesës së rëndësishme të pasigurisë në vlerësimet dhe gjykimeve kritike për zbatimin e politikave kontabël, që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, janë përfshirë në Shënimet 6 dhe 7.

4. ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE TË RISHIKUARA TË RAPORTIMIT FINANCIAR

4.1 Standarde dhe Interpretime të vlefshme në periudhën raportuese

Më poshtë paraqiten rishikimet e standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë** (i zbatueshëm për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas 1 janarit 2013)

Agjencia ka zbatuar SNRF 13 për herë të parë në vitin aktual. SNRF 13 krijon burimin e vetëm udhëzimi për matjet e vlerave të drejta dhe të informacioneve shpjeguese mbi matjet e vlerave të drejta. Objekti i SNRF 13 është i gjerë; kërkesat mbi matjet e vlerës së drejtë të SNRF 13 zbatohen tek të dyja, si tek zërat e instrumentave financiarë dhe tek zërat e aktiveve jo financiare për të cilat të tjera SNRF kërkojnë dhe lejojnë matje të vlerës së drejtë dhe informacione shpjeguese mbi matjet e vlerës së drejtë, përveç transaksioneve me pagesa të ndara që janë objekt i SNRF 2 transaksionet me pagesa të ndara dhe ato të qirasë financiare që janë objekt i SNK 17 “Qiratë” dhe matjet që kanë ngjashmëri me vlerën e drejtë por nuk janë të tilla (për shembull vlera neto e realizueshme për qëllime të matjes së inventarëve apo vlera në përdorim për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit).

SNRF 13 e përkufizon vlerën e drejtë si çmimi që do të merrej apo do të shitej një aktiv, apo do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm të tregut kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes, sipas kushteve aktuale të tregut. Vlera e drejtë sipas SNRF 13 është një çmim daljeje, pavarësisht nëse çmimi është drejtpërdrejt i verifikueshëm apo i vlerësuar duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi. Gjithashtu SNRF 13 përmban kërkesa më të zgjeruara paraqitjeje. SNRF 13 kërkon zbatim në prespektivë nga 1 janari 2013. Megjithatë Agjencia zgjodhi të zbatojë standardin që nga data e kalimit, 1 janar 2012.

4. ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBETARE TË REJA DHE TË RISHIKUARA TË RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe Interpretimet e vlefshme në periudhën raportuese (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”- Paraqitja e zërave të të ardhurave përmbledhëse** (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrikut 2012).

Ndryshimet në SNK 1 prezantojnë terminologji të re për pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e të ardhurave.

4.2 Standardet dhe Interpretimet të publikuara por ende të pazbatuara

Në datën e pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por ende nuk ishin efektive.

- **SNRF 9 “Instrumentat Financiarë”** (i zbatueshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 9 “Instrumentat Financiarë” dhe SNRF 7 “Instrumentat Financiarë: Paraqitja” – Data e hyrjes në fuqi dhe dhënia e informacioneve shpjeguese gjatë tranzicionit** (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare”, SNRF 12 “Paraqitja e Interesave në Njësi të Tjera” dhe SNK 27 “Pasqyrat Financiare të Veçuara” – Njësitë investuese** (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 32 “Instrumentat Financiarë: Paraqitja”- Kompensimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare** (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2014),
- **Ndryshime në SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve”- Paraqitjet e shumave të rikuperueshme për aktivet jo financiare** (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janaritit 2014),
- **Ndryshime në SNK 39 “Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja”- Novacioni i Derivateve dhe Vazhdimësia e Kontabilitetit Mbrojtës** (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2014),
- **KIRFN 21 “Tarifat”** (i zbatueshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2014)

Agjencia ka zgjedhur të mos i zbatojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave kur ato bëhen të zbatueshme. Drejtimi parashikon se zbatimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Agjencisë në periudhën e zbatimit fillestar, për shkak të natyrës së kufizuar të transaksioneve që kryen Agjencia.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDESISHME KONTABËL

5.1 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Fitimi ose humbja nga zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat e periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj e përkthyer me kursin e këmbimit në fund të periudhës.

Aktivët dhe detyrimet jomonetare të përkthyer në monedhë të huaj, të cilat mbahen me kosto historike, ripërkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit të cilat janë rezultat i ripërkthimit, njihen në fitim/humbje.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore, të përdorura për të përkthyer zërat e bilancit në LEK janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
EURO	140.20	139.59
Dollari amerikan (USD)	101.86	105.85
Franga zviceriane (CHF)	114.41	115.65

5.2 Kontributet dhe primet e sigurimit të depozitave

Bazuar në ligjin “Për sigurimin e depozitave”, primi vjetor i sigurimit përlllogarit si 0.5% e mesatares aritmetike të gjendjes së depozitave të siguruara në fund të çdo dite pune në tremujorin e fundit të vitit paraardhës. Primi vjetor paguhet me katër këste. Çdo pagesë kryhet brenda 15 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori.

Çdo bankë e siguruar paguan një kontribut fillestar prej 0.5% të kapitalit aksionar të saj, jo më vonë se 30 ditë nga data e dhënies së Liçences Bankare nga Banka e Shqipërisë. Kontributi fillestar paguhet në një kësht në llogarinë e Agjencisë pranë Bankës së Shqipërisë dhe njihet si e ardhur në periudhën kur ajo merret.

5.3 Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon në mënyrë të saktë flukset e ardhshme hyrëse dhe dalëse të parave përgjatë jetës së pritshme të aktivit apo detyrimit financiar (ose, ku është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) ndaj vlerës kontabël neto të aktivit apo detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Agjencia vlerëson flukset e ardhshme të parasë duke marrë parasysh të gjithë termat e kontratës së instrumentit financiar, por pa përfshirë humbjet e ardhshme nga kreditimi.

Përlllogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot dhe tarifat e transaksionit të marra ose të paguara që janë pjesë përbërëse të kësaj norme. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë të cilat i përkasin drejtpërdrejt blerjes apo emetimit të një aktivi apo detyrimi financiar.

5.4 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë përbërëse të normës së interesit efektiv të një aktivi apo detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDESISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Agjencia i njeh fillimisht investimet në letra me vlerë, depozitat, huatë dhe detyrimet e tjera në ditën në të cilën ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Agjencia angazhohet të blejë apo shesë aktivet. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare (përfshirë dhe aktivet dhe detyrimet e mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Agjencia bëhet palë e dispozitave të kontratës së instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Aktivitet financiare

Një aktiv ose detyrim financiar, kur ky nuk përcaktohet si i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, matet fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhuren drejtpërdrejt me blerjen apo shitjen e tij.

Agjencia i klasifikon aktivet e saj financiare në njërin prej kategorive të mëposhtme:

- hua dhe të arkëtueshme
- të mbajtura deri në maturim
- të vlefshme për shitje
- me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes dhe brenda kësaj kategorie si:
 - të mbajtura për tregtim; ose
 - të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes fitim ose humbjes.

Më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012, aktivet financiare të Agjencisë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, primet e sigurimit të arkëtueshme dhe letrat me vlerë të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim. Nuk ka patur ndryshime në klasifikimin e aktiveve financiare përgjatë viteve të mbyllura në 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012. Shiko Shënimet 5.6, 5.7 dhe 5.8.

Detyrimet financiare

Agjencia i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç garancive financiare dhe angazhimeve të huasë, si të matura me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

Më 31 dhjetor 2013, 31 dhjetor 2012 detyrimet financiare të Agjencisë përbëhen vetëm nga të pagueshmet ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera të matura me koston e amortizuar.

(iii) Çrregjistrimi

Aktivitet financiare

Agjencia çrregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë përfundojnë apo i transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë me anë të një transaksioni i cili transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e ardhshme që rrjedhin nga pronësia e aktivitet financiar, ose në të cilin Agjencia, as nuk mban dhe as nuk transferon në thelb rreziqet dhe përfitimet e ardhshme që rrjedhin nga pronësia dhe as nuk mban kontrollin e aktivitet financiar. Cdo interes i krijuar apo i mbajtur nga Agjencia mbi aktivet financiare të transferuara, të cilat kualifikohen për çrregjistrim, njihet më vete si aktiv apo detyrim.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çrregjistrimi (vazhdim)

Aktivitetet financiare (vazhdim)

Në çrregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlerës së mbartur që i alokohet pjesës së transferuar të aktivitetit) dhe shumës së (i) shumave të marra (përfshirë çdo aktiv të ri në zotërim minus çdo detyrim të ri të marrë) dhe (ii) çdo fitim apo humbje kumulative të njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse, njihet në fitim/ humbje.

Detyrimet financiare

Agjencia çrregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të saj janë përmbushur, ndërprerë apo anuluar.

(iv) Kompensimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten me shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur, Agjencia ka një të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe kur ajo ka si qellim ose t'i shlyejë ato me vlerën neto ose ta realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten me bazë neto vetëm kur lejohet nga SNRF, ose për fitim/humbje që rrjedhin nga transaksione të ngjashme si në rastin e aktivitetit tregues të Agjencisë.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera me të cilën është njohur në fillim aktivi apo detyrimi financiar, minus pagesat e shlyerjes së principalit, plus apo minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë midis shumës fillestare të njohjes dhe shumës në maturim, minus çdo zbritje apo zhvlerësim.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi me të cilën një aktiv do të këmbehej, ose një detyrim do të shlyej, në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme, mes palëve të gatshme, të mirë informuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën, në datën e matjes.

Kur është e mundur, Agjencia mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e listuar në një treg aktiv të këtij instrumenti. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e listuara janë direkt dhe rregullisht të disponueshme dhe përfaqësojnë transaksione aktuale dhe të rregullta të tregut, të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën.

Kur nuk ka çmim të listuar në një treg aktiv, Agjencia përdor ato teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të verifikueshme dhe minimizojnë ato jo të verifikueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të merrin parasysh në përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Informacioni më i mirë për të përcaktuar vlerën e drejtë të një instrumenti financiar gjatë njohjes fillestare të tij është normalisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë apo marrë. Nëse Agjencia përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk përcaktohet, as me anë të një çmimi të listuar në një treg aktiv për një aktiv apo detyrim të njëjtë dhe as duke u bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna nga tregje të verifikueshme, instrumenti financiar fillimisht njihet me vlerën e drejtë, të rregulluar, për të shmangur diferencën midis vlerës së drejtë në njohje dhe çmimit të transaksionit.

**5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
(VAZHDIM)**

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Më pas, kjo diferencë njihet në fitim/humbje mbi një bazë të përshtashme përgjatë jetës së instrumentit por jo më vonë se koha kur vlerësimi mbështet plotësisht nga të dhëna të verifikueshme të tregut apo transaksioni është mbyllur.

Nëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë, ka një çmim oferte dhe një çmim kërkesë, Agjencia i mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmim oferte dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim kërkesë.

Politika kontabël e matjes me vlerën e drejtë e Agjencisë është paraqitur në Shënimin 7.1.

Agjencia mat vlerën e drejtë duke ndjekur renditjen e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyrojnë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjeve:

- **Kategoria 1:** të dhëna që janë çmimet e tregut të listuara (të pa rregulluara), në një treg aktiv për instrumenta të njëjtë.
- **Kategoria 2 :** të dhëna, të ndryshme nga çmimet e listuara në treg të përfshira në nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme si drejtpërdrejt (si p.sh. çmimet) apo jo drejtpërdrejt (p.sh. të rrjedhura nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumentat e vlerësuar duke përdorur: çmimet e tregut të listuara në një treg aktiv të instrumentave të ngjashëm; çmimet e listuara të instrumentave të njëjtë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të verifikueshme drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt me të dhënat e tregut.
- **Kategoria 3:** të dhëna jo të verifikueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet në të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë të dhëna jo të bazuara në informacione të verifikueshme dhe ku të dhënat jo të verifikueshme kanë ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen në bazë të çmimeve të listuara për instrumenta të ngjashëm, që kërkojnë rregullime apo supozime të paverifikueshme të rëndësishme për të pasqyruar diferencat midis instrumentave.

Vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të tregtueshme në tregje aktive, bazohen në çmimet e tregut të listuara apo listimet e çmimeve nga ana e tregtuesit. Për të gjithë instrumentat e tjerë financiarë Agjencia përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera vlerësimi.

Teknika të tjera vlerësimi përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto dhe të aktualizimit të flukseve të parasë dhe krahasime me instrumenta të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime të verifikueshme të tregut.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është matja e një vlere të drejtë e cila të reflektojë çmimin që do të ishte marrë në shitje të aktivit apo do të ishte paguar për transferimin e detyrimit, në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Çmimet e verifikueshme dhe të dhënat e modelit janë zakonisht të disponueshme në tregjet e letrave me vlerë, derivativeve të tregtueshme dhe derivativeve të thjeshta mbi banak (jashtë bursave) si swap-et e normës së interesit. Disponueshmëria e çmimeve të verifikueshme të tregjeve dhe të dhënave të modelit ul nevojën e gjykimeve dhe vlerësimeve nga ana e Drejtimit dhe gjithashtu ul pasigurinë lidhur me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të verifikueshme të tregjeve luhatet në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe priret të ndryshojë në bazë të kushteve të përgjithshme dhe ngjarjeve të caktuara në tregjet financiare.

Agjencia njih transferimet midis kategorive në renditjen e vlerave të drejta në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Agjencia vlerëson nëse ka evidenca objektive që aktivet financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes të jenë zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare zhvlerësohet kur evidenca objektive dëshmojnë që një ngjarje që shkakton humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (aktiveve) dhe që kjo ngjarje ka ndikim në flukset e ardhshme të aktivit (aktiveve) që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë vështirësi të rëndësishme financiare të emetuesit të borxhit, dështimi ose kundërvajtje të palës tjetër, zhdukje të një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të verifikueshme lidhur me një grup aktivesh siç janë ndryshimet e pafavorshme në statusin e shlyerjes së një kredimarrësi në grup, apo kushte ekonomike që lidhen me dështime në grup.

Agjencia merr parasysh evidencat e zhvlerësimit të huave, parapagimeve dhe të investimeve në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim në nivelin e aktivitetit të caktuar. Të gjitha investimet e rëndësishme individuale në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim vlerësohen për zhvlerësime specifike.

Humbjet nga zhvlerësimi për aktivet e matura me koston e amortizuar llogariten si diferencë e vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare efektive të interesit për aktivin specifik.

5.6 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në dorë, llogaritë rrjedhëse me bankat dhe depozitat shumë likuide në Bankën e Shqipërisë me afat maturimi tre muaj ose më pak, që janë të ekspozuara ndaj një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe që përdoren nga Agjencia në administrimin e aktiviteteve operative afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

5.7 Primet e sigurimit të arkëtueshme

Primet e sigurimit të arkëtueshme përbëjnë këstin e katërt dhe të fundit të primeve vjetore të sigurimit, i cili është i pagueshëm brenda 15 ditëve nga data e raportimit. Primet e sigurimit të arkëtueshme mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

**5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
(VAZHDIM)**

5.8 Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë, kur këto nuk përcaktohen si të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte shtesë të transaksionit dhe më pas maten në varësi të klasifikimit të tyre si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes apo të vlefshme për shitje.

(i) Të mbajtura deri në maturim

Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim janë aktive jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe afat maturimi të përcaktuar, të cilat Agjencia ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk janë klasifikuar si të matura me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes apo si të vlefshme për shitje.

Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Një shitje apo riklasifikim i një shume të rëndësishme të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim do të çonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe nuk do ta lejonte Agjencinë t'i klasifikonte investimet në letra me vlerë si të mbajtura deri në maturim për vitin aktual dhe për dy vitet financiare në vijim.

Megjithatë shitjet dhe riklasifikimet në çdonjërin nga situatat e mëposhtme nuk do të çonte në një riklasifikim të kushtëzuar:

- shitjet apo riklasifikimet të cilat janë shumë afër maturimit dhe ndryshimet në normën e interesit të tregut nuk do të kishin ndikim të rëndësishëm në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar;
- shitjet apo riklasifikimet pasi Agjencia ka mbledhur në masë të konsiderueshme të gjithë principalin fillestar të aktivitetit; dhe
- shitjet apo riklasifikimet që i atribuohen një ngjarjeje të izoluar, jo të përsëritshme jashtë kontrollit të Agjencisë, e cila nuk mund të parashikohej.

5.9 Prona dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronave dhe pajisjeve maten me kosto, minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbjeje e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjithë shpenzimet të cilat lidhen direkt me blerjen e një aktivi.

Cdo fitim apo humbje në nxjerjen jashtë të një zëri të pronave dhe pajisjeve (e llogaritur si diferenca midis të hyrave neto nga nxjerrja jashtë përdorimi dhe vlerës kontabël neto) njihet si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitim/humbjes.

(ii) Kosto e mëpasshme

Një shpenzim i mëpasshëm kapitalizohet vetëm kur është e mundur që Agjencisë t'i rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike nga ky shpenzim. Riparimet dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.9 Prona dhe pajisje (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të alokuar koston minus vlerën e mbetur të vlerësuar të një zëri të pronave apo pajisjeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitim/humbjes. Aktivet e marra me qira financiare amortizohen përgjatë afatit më të shkurtër mes jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qirasë. Toka nuk amortizohet.

Llogaritjet e jetës së dobishme të zërave të rëndësishme të pronave dhe pajisjeve, për periudhën aktuale dhe ato të krahasueshme, janë si më poshtë:

- | | |
|------------------------|------------|
| • Ndërtesa | 25-40 vjet |
| • Pajisje kompjuterike | 3-5 vjet |
| • Autovetura | 5 vjet |
| • Pajisje zyre | 3-20 vjet |

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen kur është e përshtatshme.

5.10 Aktivet jo materiale, neto

Aktivitet jo materiale përfshijnë programin kompjuterik kontabël Alpha Platinum dhe programin kompjuterik Enterprise Resource Planning, të blerë nga Agjencia dhe të matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje zhvlerësimi. Programet kompjuterike amortizohen në mënyrë lineare për një periudhë tre vjeçare.

5.11 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Agjencia ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkohet një dalje e përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin.

Provigjonet për kompensimin e depozitave të siguruara

Provigjonet për kompensimin e depozitave të siguruara paraqesin vlerësimet më të mira të Agjencisë për detyrimet aktuale si rezultat i një ndërhyrjeje në një institucion të siguar për të cilin Agjencia është njoftuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë ose kur ky institucion likuidohet vullnetarisht.

Një provigjon i tillë njihet në periudhën kur ka filluar likuidimi vullnetar i institucionit ose kur është njoftuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë për ndërhyrjen në këtë institucion.

Në 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 nuk kanë ndodhur ngjarje të tilla (shiko Shënimin 6.3), ndaj nuk është njohur ndonjë provigjon në pasqyrën e pozicionit financiar.

5.12 Taksat

Në përputhje me Ligjin Nr.8873, datë 29 mars 2002 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, Agjencia është e përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi fitimin.

5.13 Kontributet e punonjësve

Agjencia paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për të përcaktuar kufijtë ligjorë për këto kontribute në Shqipëri. Kontributet e Agjencisë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit ngarkohen në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve kur ato ndodhin.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Gjatë rrjedhjes së zakonshme të veprimtarisë, Agjencia është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqeve financiare, ku më të rëndësishmit janë rreziku i tregut (ku përfshihet rreziku i monedhës, rreziku i ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe në normat e interesit), rreziku i kredisë dhe i likuiditetit. Administrimi i rrezikut në përgjithësi fokusohet në identifikimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në rezultatet dhe pozicionin financiar të Agjencisë dhe në minimizimin e efekteve negative potenciale që mund të vijnë nga këto rreziqe.

Rreziqet financiare aktualisht identifikohen, maten dhe kontrollohen përmes mekanizmave të ndryshme të ndërrmarra për të vlerësuar si duhet ngjarjet e tregut lidhur me investimet dhe mënyrat e mbajtjes së aktiveve likuide me qëllim parandalimin e përqëndrimit të tepruar të rrezikut.

Drejtimi i ASD-së përpiket të përmirësojë metodat e vlerësimit dhe administrimit të rreziqeve lidhur me portofolin e investimeve (rrezikun e kredisë, likuiditetit, interesit dhe monedhës) me qëllim sigurimin e administrimit efektiv të fondeve dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve të Agjencisë ndaj depozituesve të siguar në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Me qëllim minimizimin e rreziqeve, Agjencia mban kufizime në ekspozimin ndaj monedhës, kufizime të maturitetit dhe një portofol me kohëzgjatje jo më shumë se dymbëdhjetë muaj. Gjithashtu Agjencia ka hyrë në një marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, e cila e lejon atë në rast ngjarje sigurimi, të sigurojë likuiditet duke zbatuar me Ministrinë e Financave, një marrëveshje shitjeje dhe riblerjeje të letrave me vlerë të Qeverisë së Shqipërisë që ajo zotëron.

Operacionet financiare të Agjencisë rregullohen nga ligji për sigurimin e depozitave dhe Politika e Investimit e Agjencisë. Ligji kërkon që të ardhurat e marra nga institucionet anëtare të skemës të investohen në tituj të emetuar nga Qeveria e Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë, tituj të emetuar nga qeveri ose banka qendrore të huaja qendrore të vlerësuar si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit, tituj të emetuar nga institucione financiare ndërkombëtare të vlerësuar si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit, ose të vendosen në depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë. Të gjitha investimet duhet të kenë një afat maturimi jo më të gjatë se dymbëdhjetë muaj nga data e blerjes së tyre nga Agjencia.

Politika e Investimit, e cila miratohet nga Këshilli Drejtues, përcakton procedurat e investimit dhe vendos kufijtë për cilësinë e instrumentave të huaj, përqëndrimin sipas maturitetit dhe përqëndrimin sipas monedhës në lidhje me portofolin e investimeve të Agjencisë. Komiteti i Investimeve të ASD-së është përgjegjës për të garantuar që strategjia e zbatuar e investimeve dhe struktura e portofolit të jenë në përputhje me Politikën e Investimit. Struktura e aktiveve dhe detyrimeve financiare vlerësohet rregullisht bazuar në informacionet e marra nga Sektori i Financës dhe Investimeve, Sektori i Analizës së Rrezikut dhe Banka e Shqipërisë. Komiteti i Investimeve raporton periodikisht tek Këshilli Drejtues mbi performancën e portofolit të investimeve.

6.1 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare shkaktuar Agjencisë nëse pala tjetër në një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga investimet në letra me vlerë të Agjencisë dhe gjendjeve të llogarive në banka. Për qëllime raportimi lidhur me administrimin e rrezikut, Agjencia merr parasysh dhe përfshin të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë siç janë rreziku i dështimit të debitorëve individualë dhe rreziku i shtetit.

Komiteti i Investimeve është përgjegjës për mbikqyrjen rrezikut të kredisë, përfshirë rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë si dhe garantimin e përputhshmërisë me kufijtë e vendosur në lidhje me ekspozimin ndaj palëve të treta /shteteve dhe me politikën e tjera përkatëse të përcaktuara në aktet nënligjore .

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë sipas palëve të treta (shteteve) dhe vonesat në ripagim apo zhvlerësimet e lidhura me to, nëse ka:

Investimet në letra me vlerë	Qeveria e Shqipërisë	Qeveria e SHBA-së	Qeveria e Austrisë	Qeveria e Gjermanisë	Qeveria e Francës	Qeveria e Finlandës	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2013</i>							
Jo me vonesë apo të zhvlerësuara	19,013,091,170	378,851,359	-	-	-	-	19,391,942,529
<i>Më 31 dhjetor 2012</i>							
Jo me vonesë apo të zhvlerësuara	15,326,940,858	632,662,064	-	-	-	-	15,959,602,922

Agjencia nuk ka angazhime financiare të kushtëzuara më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku ndryshimit të çmimit të tregut të aktiveve si rezultat i një ndryshimi të normave të interesit, kurseve të këmbimit dhe marzhet në interesat e kredisë (jo lidhur me ndryshimet në cilësinë e kreditimit të emetuesit/debitorit) të cilët do të ndikojnë në të ardhurat e Agjencisë ose vlerën e instrumentave financiarë të zotëruar prej saj. Qëllimi i Agjencisë në administrimin e rrezikut të tregut është drejtimi dhe kontrolli mbi ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, me qëllim sigurimin e aftësisë paguese të Agjencisë duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut..

(i) *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit– investimet e mbajtura deri në maturim*

Rreziku kryesor, ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet jo-të-tregtueshme, është rreziku i humbjeve nga luhatjet e flukseve të ardhshme të pasasë të instrumentave financiare ose vlerave të drejta të tyre, për shkak të një ndryshimi në normat e interesit në treg. Rreziku i normës së interesit administrohet kryesisht duke monitoruar ekspozimin neto në instrumentat financiare që bartin interes dhe duke miratuar paraprakisht kufijtë për këto ekspozime. Komiteti i Investimeve është organi mbikqyrës i përputhshmërisë me këto kufij.

Një përmbledhje e pozicionit neto të Agjencisë në portofolet jo-të-tregtueshme paraqitet si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2013	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	330,407,938	330,407,938	-	-	-
Primet e sigurimit të arkëtueshme	684,388,183	684,388,183	-	-	-
Investime të mbajtura deri në maturim	19,391,942,529	2,825,556,029	2,460,392,885	4,654,552,832	9,451,440,783
TOTALI	20,406,738,650	3,840,352,150	2,460,392,885	4,654,552,832	9,451,440,783

Më 31 dhjetor 2012	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	152,453,245	152,453,245	-	-	-
Primet e sigurimit të arkëtueshme	586,858,438	586,858,438	-	-	-
Investime të mbajtura deri në maturim	15,959,602,922	2,032,310,923	2,052,821,676	4,138,766,076	7,735,704,247
TOTALI	16,698,914,605	2,771,622,606	2,052,821,676	4,138,766,076	7,735,704,247

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)***(i) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit– investimet e mbajtura deri në maturim (vazhdim)*

Drejtimi mori parasysh një skenar standard që përfshin një ulje ose rritje paralele prej 100 pikësh bazë (bp) në të gjitha kurbat e normave të interesit në botë. Një analizë e ndjeshmërisë së Agjencisë ndaj një rritjeje apo uljeje në normat e interesit të tregut paraqitet më poshtë:

Ndryshimi në norma	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
+100bp	110,026,206	88,874,779
-100bp	(110,026,206)	(88,874,779)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Rreziku i monedhës përkufizohet si rreziku që luhatjet në kurset e këmbimit të shkaktojnë ndryshime të rëndësishme, pozitive ose negative, në pasqyrën e pozicionit financiar. Agjencia është kryesisht e ekspozuar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kursin e këmbimit të dollarit amerikan (USD) dhe Euro-s ndaj LEK-ut. Ekspozimet aktuale janë të natyrës afatshkurtër dhe kufizimet lidhur me këto ekspozime vendosen dhe monitorohen në përputhje me Politikën e Investimit të Agjencisë.

Një përmbledhje e ekspozimit neto ndaj monedhës paraqitet më poshtë (vlerat në LEK):

Më 31 dhjetor 2013	LEK	USD	EUR	CHF
AKTIVET				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	56,725,088	121,254,633	152,422,359	5,858
Primet e sigurimit të arkëtueshme	684,388,183	-	-	-
Investime të mbajtura deri në maturim	18,504,413,408	378,851,359	508,677,762	-
TOTALI	19,245,526,679	500,105,992	661,100,121	5,858
DETYRIMET				
Detyrime të tjera	(4,047,511)	-	-	-
TOTALI I DETYRIMEVE	(4,047,511)	-	-	-
EKSPOZIMI NETO NDAJ KURSIT TË KËMBIMIT	19,241,479,168	500,105,992	661,100,121	5,858

Më 31 dhjetor 2012	LEK	USD	EUR	CHF
AKTIVET				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	143,681,647	629,173	8,142,425	-
Primet e sigurimit të arkëtueshme	586,858,438	-	-	-
Investime të mbajtura deri në maturim	14,701,622,048	632,662,064	625,318,810	-
TOTALI	15,432,162,133	633,291,237	633,461,235	-
DETYRIMET				
Detyrime të tjera	(1,759,690)	-	-	-
TOTALI I DETYRIMEVE	(1,759,690)	-	-	-
EKSPOZIMI NETO NDAJ KURSIT TË KËMBIMIT	15,430,402,443	633,291,237	633,461,235	-

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhës së huaj

Tabela më poshtë paraqet ndjeshmërinë ndaj një rritje/rënie me 10 përqind në kurset e këmbimit të LEK-ut ndaj USD dhe EURO në datën e raportimit bazuar në strukturën e aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj të Agjencisë më 31 dhjetor, duke supozuar se të gjithë variablat e tjerë mbeten të pandryshuar. Efekti është matur dhe paraqitur si një ndikim në rezultat dhe direkt në aktivet neto, duke mbajtur të pandryshuara kushtet e tjera.

	USD		EURO	
	+10%	-10%	+10%	-10%
Më 31 dhjetor 2013	50,010,599	(50,010,599)	66,110,012	(66,110,012)
Më 31 dhjetor 2012	63,329,124	(63,329,124)	63,346,124	(63,346,124)

Me një rritje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të USD ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar të Agjencisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, do të ishte një rritje prej 50,010,599 Lek (31 dhjetor 2012: 63,329,124 Lek) si rezultat i ekspozimit ndaj letrave me vlerë dhe gjendjeve të llogarive afatshkurtra në USD. Respektivisht, ndikimi në aktivet neto do të ishte i njëjtë.

Me një ulje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të USD ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Agjencisë do të ishte i njëjtë, por në drejtim të kundërt me ndikimin e rritjes të përshkruar më sipër.

Me një rritje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të EURO ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar të Agjencisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, do të ishte një rritje prej 66,110,012 Lek (31 dhjetor 2012: 63,346,124 Lek) si rezultat i ekspozimit ndaj letrave me vlerë dhe gjendjeve të llogarive afatshkurtra në EURO. Respektivisht, ndikimi në aktivet neto do të ishte i njëjtë.

Me një ulje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të EURO ndaj LEK-ut, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Agjencisë do të ishte i njëjtë, por në drejtim të kundërt me ndikimin e rritjes të përshkruar më sipër.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Agjencia do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet e saj financiare që shlyhen duke dhënë para apo një aktiv tjetër financiar.

Politika e administrimit të likuiditetit e ASD-së është konservatore, duke mbajtur një rezervë optimale e të qëndrueshme mjetesh monetare për të siguruar kapacitetin e duhur për financimin e aktiviteteve të saj. Agjencia ka hyrë në një marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, që e lejon Agjencinë në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, të sigurojë likuiditet duke zbatuar me Ministrinë e Financave një marrëveshje shitjeje dhe riblerjeje të bonove të thesarit të Qeverisë së Shqipërisë që ajo zotëron. Gjithashtu, në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave, në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve, Agjencia ka të drejtë të kërkojë pagesa të parakohshme të primeve vjetore të sigurimit nga institucionet e siguruar, të rrisë primet vjetore, të mbledhë një kontribut të veçantë nga institucionet e siguruar dhe të marrë hua sipas kritereve të vendosura nga Këshilli Drejtues i Agjencisë (Neni 20/1 i ligjit “Për sigurimin e depozitave”).

Tabela më poshtë paraqet instrumentat financiarë të Agjencisë të klasifikuar sipas periudhës së mbetur deri në maturim në bazë të flukseve të parave kontraktuale të paaktualizuara:

Më 31 dhjetor 2013	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	Flukset totale kontraktuale të parasë
AKTIVET						
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	330,407,938	330,407,938	-	-	-	330,407,938
Primet e sigurimit të arkëtueshme	684,388,183	684,388,183	-	-	-	684,388,183
Investime të mbajtura deri në maturim	19,391,942,529	2,835,600,000	2,482,609,140	4,749,794,973	9,733,475,287	19,801,479,400
TOTALI	20,406,738,650	3,850,396,121	2,482,609,140	4,749,794,973	9,733,475,287	20,816,275,521
DETYRIMET						
Detyrime të tjera	(4,047,511)	(4,047,511)	-	-	-	(4,047,511)
TOTALI	(4,047,511)	(4,047,511)	-	-	-	(4,047,511)
HENDEKU KUMULATIV I LIKUIDITETIT	20,402,691,139	3,846,348,610	6,328,957,750	11,078,752,723	20,812,228,010	20,812,228,010

Pozicioni likuid neto më 31 dhjetor 2013 është më i madh se Fondi i Sigurimit të Depozitave më atë datë.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2012	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	Flukset totale kontraktuale të parasë
AKTIVET						
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	152,453,245	152,453,245	-	-	-	152,453,245
Primet e sigurimit të arkëtueshme	586,858,438	586,858,438	-	-	-	586,858,438
Investime të mbajtura deri në maturim	15,959,602,922	2,039,700,000	2,073,604,250	4,234,045,718	8,112,178,794	16,459,528,762
TOTALI	16,698,914,605	2,779,011,683	2,073,604,250	4,234,045,718	8,112,178,794	17,198,840,445
DETYRIMET						
Detyrime të tjera	(1,759,690)	(1,759,690)	-	-	-	(1,759,690)
TOTALI	(1,759,690)	(1,759,690)	-	-	-	(1,759,690)
HENDEKU KUMULATIV I LIKUIDITETIT	16,697,154,915	2,777,251,993	4,850,856,243	9,084,901,961	17,197,080,755	17,197,080,755

Pozicioni likuid neto më 31 dhjetor 2012 është më i madh se Fondi i Sigurimit të Depozitave më atë datë.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Qëndrueshëria financiare

Qëndrueshmëria e sektorit bankar është faktori kryesor që ndikon në pozicionin e likuiditetit të Agjencisë. Agjencia vlerëson vazhdimisht qëndrueshmërinë e sektorit bankar në mënyrë që të parashikojë detyrimet e saj kundrejt depozituesve të siguruar, në përputhje me ligjin “Për sigurimin e depozitave”.

Sipas Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit 2013, sektori bankar u vlerësua si i qëndrueshëm. Ushtrimet e testeve *Stress-test* në formën e analizave të ndjeshmërisë dhe skenarëve, të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë përgjatë 2013 dhe 2012, tregojnë se sektori bankar, në përgjithësi, është i aftë të përballojë goditje bazuar në cilësinë dhe mjaftueshmërinë e kapitalit.

Në vitin 2013, sektori bankar përjetoj normë rritjeje më të ulta dhe një rënie në aktivitetin huadhënës. Rreziku i kredisë përfaqëson sfidën më të rëndësishme për këtë sektor. Këto faktorë u pasqyruan në performancën financiare të sektorit bankar për vitin. Pavarisht këtyre zhvillimeve, sektori ka ruajtur nivele të mira të likuiditetit dhe kapitalit, në vijim të rritjes së mëtejshme të depozitave të publikut dhe shtimit të kapitalit nga grupet bankare zoteruese përgjatë vitit 2013.

7. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatueshmërinë e politikave kontabël dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të ndikuar nga këto rishikime.

Drejtimi diskuton me Këshillin Drejtues të Agjencisë zhvillimin, përzgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël të rëndësishme dhe zbatueshmërinë e tyre dhe supozimet e bëra lidhur me pasiguritë kryesore në vlerësim. Informacionet mbi supozimet dhe pasiguritë në vlerësim që kanë një rrezik të rëndësishëm që të rezultojnë në korrigjim material në vitin e ardhshëm financiar dhe informacione mbi gjykime të rëndësishme gjatë zbatimit të politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, janë paraqitur më poshtë.

Këto pasqyra plotësojnë shënimet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shiko Shënimin 6).

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***7. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)****7.1 Vlerësimi i instrumentave financiarë**

Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta të instrumentave financiare janë të paraqitura më poshtë:

Më 31 dhjetor 2013	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me koston e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
AKTIVET					
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	330,407,938	-	-	330,407,938	330,407,938
Primet e sigurimit të arkëtueshme	684,388,183	-	-	684,388,183	684,388,183
Investime të mbajtura deri në maturim	-	19,391,942,529	-	19,391,942,529	19,443,319,397
TOTALI	1,014,796,121	19,391,942,529	-	20,406,738,650	20,458,115,518
DETYRIMET					
Detyrime të tjera	-	-	(4,047,511)	(4,047,511)	(4,047,511)
TOTALI	-	-	(4,047,511)	(4,047,511)	(4,047,511)
Më 31 dhjetor 2012	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me koston e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
AKTIVET					
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	152,453,245	-	-	152,453,245	152,453,245
Primet e sigurimit të arkëtueshme	586,858,438	-	-	586,858,438	586,858,438
Investime të mbajtura deri në maturim	-	15,959,602,922	-	15,959,602,922	15,983,540,694
TOTALI	739,311,683	15,959,602,922	-	16,698,914,605	16,722,852,377
DETYRIMET					
Detyrime të tjera	-	-	(1,759,690)	(1,759,690)	(1,759,690)
TOTALI	-	-	(1,759,690)	(1,759,690)	(1,759,690)

Për shkak të afatit të shkurtër të maturimit (më pak se një muaj), Drejtimi vlerëson se vlerat e drejta të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, primet e sigurimit të arkëtueshme dhe detyrimet e tjera janë të njëjta me vlerat kontabël neto në 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

Drejtimi vlerëson vlerën e drejtë të investimeve të mbajtura deri në maturim në letra me vlerë, duke përdorur normat e verifikueshme të tregut (kategoria 2) për letra me vlerë të ngjashme me afat të ngjashëm maturimi, bazuar në afatin e mbetur deri në maturim në 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

8. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
<i>Gjendjet në banka</i>		
Llogaritë rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë	152,399,867	48,039,968
Depozitat rrjedhëse	55,500,000	100,000,000
Llogaritë rrjedhëse në bankat e vendit	1,223,701	3,265,422
Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja	121,284,370	1,147,855
Totali	330,407,938	152,453,245

Depozitat afatshkurtra përfshijnë depozitat 7-ditore në Bankën e Shqipërisë, në fund të vitit, të cilat do të investohen në Bono Thesari të Qeverisë Shqiptare në ankandin e ardhshëm.

9. PRIMET E SIGURIMIT TË ARKËTUESHME

Primet e sigurimit të arkëtueshme përbëhen nga këstet e fundit të primeve vjetore ende të pambledhura në fund të vitit.

Çdo bankë paguan primet vjetore të sigurimit në katër këste. Çdo këst duhet të paguhet në fund të çdo 3 mujori brenda datave 15 janar, prill, korrik dhe tetor.

Më 15 janar 2014, 100% e primeve të arkëtueshme më 31 dhjetor 2013 ishin mbledhur. Më 15 janar 2013, 100% e primeve të arkëtueshme më 31 dhjetor 2012 ishin mbledhur.

10. INVESTIMET NË LETRA ME VLERË-TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Investime në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare (10.1)	19,013,091,170	15,326,940,858
Investime në letra me vlerë të qeverive të huaja(10.2)	378,851,359	632,662,064
Totali	19,391,942,529	15,959,602,922

10.1 Bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare

Investime në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Bonot e thesarit në LEK	18,504,413,408	14,701,622,068
Bonot e thesarit në EUR	508,677,762	625,318,790
Totali	19,013,091,170	15,326,940,858

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***10. INVESTIMET NË LETRA ME VLERË-TË MBAJTURA DERI NË MATURIM (VAZHDIM)****10.1 Bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare (vazhdim)**

Letrat me vlerë sipas afatit kontraktual të maturimit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	Norma mesatare e ponderuar	31 dhjetor 2012	Norma mesatare e ponderuar
<i>BTH në LEK</i>				
3 muaj	496,422,378	3.06%	-	n/a
6 muaj	198,035,749	3.65%	1,752,421,990	6.13%
12 muaj	17,809,955,281	5.12%	12,949,200,078	6.87%
Totali	18,504,413,408		14,701,622,068	
<i>BTH në EURO</i>				
12 muaj	508,677,762	2.66%	625,318,790	5.04%
Totali	508,677,762		625,318,790	

Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013 u karakterizua nga nje ulje e normave të tregut per të gjitha maturimet dhe kjo tendence pati nje ndikim në të ardhurat nga investimet e Agjensisë.

10.2 Obligacionet e thesarit të qeverive të huaja

Investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja të renditura sipas monedhës dhe palëve paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	Norma mesatare e ponderuar	31 dhjetor 2012	Norma mesatare e ponderuar
<i>Obligacionet në USD</i>				
SHBA	378,851,359	0.12%	632,662,064	0.19%
Totali	378,851,359		632,662,064	

Të gjitha investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja kanë një afat maturimi kontraktual deri në 12 muaj në përputhje me politikën e administrimit të rrezikut të likuiditetit të Agjensisë. (shiko Shënimin 6.3).

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012
(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)
11. PRONA DHE PAJISJE

	Ndërtesa	Instalime teknike	Pajisje kompjuterike	Automjete	Pajisje zyre	Totali
<i>Kosto</i>						
Më 1 janar 2012	58,819,632	381,173	1,900,590	-	625,727	61,727,122
Shtesa	-	-	179,884	-	19,080	198,964
Më 31 dhjetor 2012	58,819,632	381,173	2,080,474	-	644,807	61,926,086
Shtesa	93,060	964,276	5,415,360	6,240,000	1,844,030	14,556,726
Transferime	-	727,560	(2,980,560)	-	2,253,000	-
Më 31 dhjetor 2013	58,912,692	2,073,009	4,515,274	6,240,000	4,741,837	76,482,812
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Më 1 janar 2012	(1,77,936)	(63,810)	(620,790)	-	(222,264)	(2,704,800)
Amortizimi i periudhës	(1,77,942)	(57,362)	(554,482)	-	(221,203)	(2,630,989)
Më 31 dhjetor 2012	(3,595,878)	(121,172)	(1,175,272)	-	(443,467)	(5,335,789)
Amortizimi i periudhës	(1,801,665)	(77,346)	(734,340)	(229,085)	(502,582)	(3,345,018)
Më 31 dhjetor 2012	(5,397,53)	(198,518)	(1,909,612)	(229,085)	(946,049)	(8,680,807)
<i>Vlera kontabël neto</i>						
Më 1 janar 2012	57,021,696	317,363	1,279,800	-	403,463	59,022,322
Më 31 dhjetor 2012	55,223,754	260,001	905,202	-	201,340	56,590,297
Më 31 dhjetor 2013	53,515,149	1,874,491	2,605,662	6,010,915	3,795,788	67,802,005

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***12. AKTIVET JO MATERIALE, NETO**

	Programe kompjuterike
<i>Kosto</i>	
Më 1 Janar 2012	931,500
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2012	931,500
Shtesa	3,401,400
Në 31 dhjetor 2013	4,332,900
<i>Amortizimi i akumuluar</i>	
Më 1 Janar 2012	-
Amortizimi i vitit	(120,000)
Më 31 dhjetor 2012	(120,000)
Amortizimi i vitit	(821,155)
Më 31 dhjetor 2013	(941,155)
<i>Vlera kontabël neto</i>	
Më 1 Janar 2012	931,500
Më 31 dhjetor 2012	811,500
Më 31 dhjetor 2013	3,391,745

13. AKTIVE TË TJERA, NETO

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Inventari	2,378,200	1,566,712
Shpenzime të parapaguara	817,239	597,217
Aktive të tjera	-	-
Totali	3,195,439	2,163,929

14. DETYRIME TË TJERA

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Shpenzime të përlogaritura	2,265,007	475,830
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	560,729	346,765
Tatimi mbi të ardhurat personale	623,313	642,435
Detyrime të tjera	598,462	294,660
Totali i detyrimeve të tjera	4,047,511	1,759,690

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

15. FONDI THEMELTAR

Më 31 dhjetor 2013, Fondi Themeltar prej 400,000,000 Lek (31 dhjetor 2012: 400,000,000 Lek) përfaqëson një kontribut të Buxhetit të Shtetit dhënë në momentin e themelimit të Agjencisë. Sipas ligji “Për sigurimin e depozitave”, Fondi Themeltar mund t’i rimbursohet Buxhetit të Shtetit sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar nga Këshili Drejtues i Agjencisë. Fondi Themeltar mund të rritet nga kontribute shtesë të Buxhetit të Shtetit me kërkesë të Këshilli Drejtues të Agjencisë dhe me miratim të Qeverisë së Shqipërisë. Për vitet e mbyllura në 31dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 nuk ka patur rritje apo zvogëlime në Fondin Themeltar.

16. TË ARDHURA NGA PRIMET E SIGURIMIT

Për vitin e mbyllur në 31dhjetor 2013, të ardhurat e përllogaritura të Agjencisë nga primet e sigurimit të 16 bankave ishin në shumën 2,775,118,878 Lek (2012: 2,547,690,715 Lek nga 16 banka). Primi vjetor i sigurimit llogaritet si 0.5% e mesatares aritmetike të gjendjes së depozitave të siguruara në fund të çdo dite pune të tre-mujorit të fundit të vitit të mëparshëm. Për vitin e mbyllur në 31dhjetor 2013, shuma e depozitave të siguruara (gjendja mesatare në tre-mujorin e fundit të 2012) e përdorur për të llogaritur primin vjetor të sigurimit ishte 555,024 million Lek (2012: 509,538 milion bazuar në gjendjen mesatare të depozitave të siguruara në tre-mujorin e fundit të 2011).

17. TË ARDHURAT NGA INTERESAT

Të ardhurat nga interesat për vitet e mbyllura në 31 dhjetor 2013, 2012 janë krijuar nga aktivitetet e mëposhtme:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Bonot e thesarit shqiptare në LEK	982,288,763	867,800,183
Bonot e thesarit shqiptare në EUR	26,925,065	11,309,210
Letrat me vlerë thesari të huaja në EUR	-	2,706,603
Letrat me vlerë thesari të huaja në USD	824,443	1,028,121
Depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë	19,382,250	18,629,236
Të ardhura të tjera nga interesat	16,501	15,189
Totali	1,029,437,022	901,488,542

18. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shpenzimet për paga dhe shpërblime	38,577,855	32,441,509
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	3,118,055	2,282,744
Të tjera	507,901	775,132
Totali	42,203,811	35,499,385

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

19. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Trajnime dhe edukime të vazhdueshme	8,467,187	4,445,472
Shpenzime të Këshillit Drejtues	4,063,969	4,173,632
Shërbime profesionale	2,062,000	613,440
Tarife anëtarësimi	1,408,943	1,449,080
Shërbime	1,488,194	1,346,502
Publikime dhe abonime	216,836	1,547,789
Takime dhe konferenca	381,280	50,245
Shpenzime postare dhe komunikimi	787,231	875,233
Pajisje zyre	354,972	372,812
Shpenzime të tjera operative	1,688,137	2,244,316
Totali	20,918,749	17,118,521

20. MARRËDHENIET DHE TRANSAKSIONET ME INSTITUCIONET, ORGANET DHE NDËRMARRJET SHTETËRORE

Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave janë institucionet shtetërore me të cilat Agjencia ka ndërtuar marrëdhënie të rregullta në bazë të statusit dhe funksioneve të saj ligjore dhe në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.

Agjencia drejtohet nga Këshilli Drejtues, anëtarët e të cilit emërohen në përputhje me ligjin "Për sigurimin e depozitave (Shënimi 1).

Një pjesë e rëndësishme e aktiveve financiare janë investuar në instrumenta borxhi të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë ose vendosur në depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë (Shënimet 8 dhe 10). Investimet në letra me vlerë blihen si në tregun primar përmes pjesëmarrjes në ankande edhe në tregun dytësor.

21. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Agjencia ka vlerësuar ngjarje të mëpasshme deri më 28 shkurt 2014, datë kur këto pasqyra financiare ishin të gatshme për publikim. Në janar 2014 Agjencia përgatiti një projekt ligj të ri për të zëvendësuar ligjin aktual për sigurimin e depozitave. Projektligji u shqyrtua nga Autoriteti Mbikëqyrës, i cili më pas ia dërgoi për shqyrtim Ministrisë së Financave në 11 shkurt 2014. Projektligji është aktualisht nën shqyrtimin e Ministrisë së Financave, e cila ka autoritetin ta dërgojë në Kuvend për diskutim dhe votim. Kjo ngjarje nuk kërkon ndonjë rregullim apo informacion shpjegues shtesë në pasqyrat financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit dhe deri më 28 shkurt 2014 që kërkon rregullime apo informacione shpjegues shtesë në pasqyrat financiare të Agjencisë.